

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7914
E premte, 25 tetor 2024
Çmimi 0.50 €

Shqiptarëve në jug të Serbisë nuk u njihen diplomat e Kosovës **FAQE 6**



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPOZITA KËRKON HETIME PËR PËRFSHIRJEN E MIHALIT NË TREGTIMIN E RRYMËS DHE NDËRHJRJET NË KEK **FAQE 4-5**



Të enjten është mbajtur seancë e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kosovës, e thirrur nga grupi parlamentar i LDK-së, i mbështetur

edhe nga 43 deputetë të tjerë lidhur me situatën në Korporatën Energjetike të Kosovës. Opozita ka kërkuar hetime për përfshirjen e Dejona Mihalit në

tregtimin e rrymës dhe ndërhyrjet në KEK. Edhe në këtë seancë nuk ishin të pranishëm deputetët e LV-së dhe kabineti qeveritar

INTERVISTË ME ZOGE SHALËN, ANËTARE E GRUPIT TË TË RINJVE TË PEJËS TË PAJTIMIT TË GJAQEVË NË KOSOVË 1990-1991

ÇDO FALJE GJAKU ÇONTE DREJT PAJTIMIT DHE BASHKIMIT TË POPULLIT TONË **F. 3**



ASOCIACIONI PRITET T'I MBETET DETYRË KRYEMINISTRIT TË ARDHSHËM **F. 7**



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SPORT



PËRUROHEN TRIBUNAT E REJA DHE ZHVESHTORET NË STADIUMIN E MALISHEVËS **F. 10**

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ukraina rrëzon dhjetëra dronë të Rusisë

KIEV, 24 TETOR - Mbrojtja ukrainase ka rrëzuar 40 nga 50 dronët që lëshoi Rusia ndaj 11 rajoneve ukrainase mëngjesin e 24 tetorit.

Forcat ajrore ukrainase thanë se shtatë dronë rusë u rrëzuan për shkak se patën telashe me

sistemin e tyre të navigimit. Dronët u rrëzuan në rajonet e Odesës, Mikolajivit, Dnipropetrovskit, Vinitjas, Zhitomirit, Kmelnitskit, Çerkasit, Kirovoradit, Kievit, Poltavës dhe Çernihivit, teksa forcat ajrore shtuan se një dron

mbeti në hapësirën ajrore ukrainase, ndërkaq dy të tjerë u larguan në drejtim të Rusisë dhe Bjellorusisë.

Ushtria ukrainase, ndërkaq, njoftoi se Rusia ka gjuajtur dy raketa precize dhe dy raketa lundruese, duke pretenduar se

raketat nuk goditën në caqe. Rusia ka nisur pushtimin e paprovokuar të Ukrainës në shkurt të vitit 2022 dhe që atëherë sulmon rajonet ukrainase me lloje të ndryshme armësh, përfshirë dronë dhe raketa.



Von der Leyen në Tiranë: Zgjerimi, prioritet i mandatit tim të dytë

TIRANË, 24 TETOR - Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka thënë se zgjerimi i Bashkimit Evropian është prioritet i saj edhe në mandatin e saj të dytë si shefe e organit ekzekutiv të bllokut, pas një takimi me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, në Tiranë. "Zgjerimi është përparësi e lartë edhe në mandatin tim të ardhshëm. Ka të bëjë me planin tonë të rritjes për Ballkanin Perëndimor. E diskutuam edhe në Berlin. Ne hapim derën tonë të tregut të përbashkët me partnerët e Ballkanit Perëndimor", tha Von der Leyen në një konferencë të përbashkët për medie me Ramën. Gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor që Von der Leyen po i viziton këtë javë - Shqipëria, Serbia, Bosnjë-Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Mali i Zi - kanë me vite të tëra që synojnë t'i bashkohen bllokut.

Më vonë gjatë një vizite te Kolegji Evropian në Tiranë, Von der Leyen tha se tani "po fryn një erë ndryshimesh në Ballkanin Perëndimor". "A mund ta ndalojë kush erën e ndryshimeve? Sot kjo erë ndryshimesh po fryn jo vetëm në Ballkanin Perëndimor, por dhe në Ukrainë e Moldavi. Por, ka dhe erëra të tjera që fryjnë në drejtime të kundërta, drejt nacionalizmit apo shtypjes. Rusia ka hyrë në Ukrainë pikërisht për faktin se Ukraina donte të bëhej pjesë e BE-së", tha ajo, duke iu referuar pushtimit të plotë të Ukrainës që Moskë e nisi në shkurt 2022.

Ajo përmendi edhe zgjedhjet dhe referendumin në Moldavi, ku kishte dyshime për përzjerjen e Rusisë, në të cilin më shumë se gjysma e moldavëve votuan për



integritet në BE. "Dhe në Moldavi fundjavën e shkuar pamë ndërhyrjen e shkuar të Rusisë në referendumin për të ardhmen evropiane. Këto forca po punojnë për të destabilizuar vende që zgjedhin Evropën. Sa herë ka progres drejt pajtimit apo integritetit janë ata që sjellin në vëmendje konflikte të vjetra. Ky është realiteti i sotëm. Me këtë do të duhet të përballet brezi juaj i evropianëve të rinj. Nuk duhet të rrimë duarkryq", tha Von der Leyen para studentëve të Kolegjit Evropian.

Shefja e KE-së, e cila mbërriti në

Tiranë një ditë më parë, për ta nisur turneun e saj në rajon, njoftoi se Shqipëria do ta pranojë në muajt në vijim kështu e parë prej 64 milionë eurosh nga Plani i Rritjes i BE-së, nga 920 milionë euro në përgjithësi sa pritet t'i marrë në tri vjetet e ardhshme.

Së fundi, BE-ja e miratoi Planin e Rritjes për Ballkanin Perëndimor që parasheh ndihmë prej 6 miliardë eurosh për shtetet e këtij rajoni. "Ka një vit prej kur filloi puna dhe shumica e kanë gati agjendën e reformave. Ju dhe ekipi keni bërë në punë të shkëlqyer për agjendën e

reformave", tha ajo drejtuar Ramës.

E pyetur nëse ka ndonjë datë kur Shqipëria do të mund ta bëhej anëtare e BE-së, Von der Leyen tha se kjo varet nga "puna dhe meritat".

Shqipëria e hapi kapitullin e parë të negociatave për anëtarësim me Bashkimin Evropian më 15 tetor, plot 10 vjet pasi e kishte marrë statusin e vendit kandidat.

Rama tha se Shqipëria është e "vendosur" për t'i kryer detyrat e saj në rrugën drejt BE-së. "Jemi shumë të vendosur t'ia dalim. Janë një sërë detyrash. Janë

mijëra! Detyra që duhet të përkthehen në ligje, akte nënligjore, por dhe në prova të zbatimit", tha Rama.

Gjatë vizitës në kryeqytetin e Shqipërisë, shefja e KE-së është paraparë të zhvillojë takime me presidentin Bajram Begaj të entjen në mëngjes.

Sipas paralajmërimeve nga KE-ja, gjatë vizitës në rajon Von der Leyen do të përqendrohet më së shumti në ndihmën që Bashkimi Evropian po ua jep vendeve të rajonit për përshejtimin e reformave dhe përgatitjeve për përparim më të shpejtë në procesin e integritimeve evropiane.

Javë më parë BE-ja i miratoi agjendat e reformave të pesë vendeve të Ballkanit Perëndimor të cilat i kanë paraqitur ato si kusht për të përfutur nga paketa e Planit të Rritjes.

Pas Shqipërisë, më 24 tetor Von der Leyen do të shkojë në Maqedoninë e Veriut dhe në Bosnjë-Hercegovinë. Në Bosnjë ajo do t'i vizitojë edhe zonat e goditura nga përmbytjet e 4 tetorit dhe do të shprehë gatishmërinë e BE-së për të ndihmuar në përbërje me pasojat.

Në Serbi, Von der Leyen do të qëndrojë më 25 tetor, ku do të takohet me presidentin serb Aleksandar Vučić.

Von der Leyen do të udhëtojë pastaj për vizitë në Kosovë të shtunën e 26 tetorit, ku do të takohet me presidenten Vjosa Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti.

Vizitën në rajon ajo do ta përfundojë me takimin me liderët e Malit të Zi të shtunën në Podgoricë.

Franca, ndihmë për Libanin në vlerë prej 100 milionë eurosh

PARIS, 24 TETOR - Franca do t'i japë Libanit një paketë të ndihmës në vlerë prej 100 milionë eurosh, bëri me dije presidenti francez Emmanuel Macron gjatë një konference ndërkombëtare në Paris më 24 tetor.

Macroni tha se "është e nevojshme që ndihma masive e menjëhershme për popullin libanez, si për qindra mijëra njerëz të zhvendosur nga lufta, por edhe për komunitetet që

po i strehojnë".

Lufta mes Hezbollahut - grupit militant dhe partisë politike libaneze dhe Izraelit - ka detyruar një milion persona të zhvendosen në Liban.

Si pasojë e luftimeve, më shumë se 2 500 persona janë vrarë dhe është thelluar kriza ekonomike në Liban.

Organizatorët francezë të konferencës ndërkombëtare kanë thënë se shpresojnë që pjesëmarrësit të zotohen për

ndihmë humanitare që do ta arrijë shifrën prej 426 milionë dollarësh që, sipas Kombeve të Bashkuara, i duhen urgjentisht Libanit.

Parisi, po ashtu, ka thënë se dëshiron të ndihmojë në rivendosjen e sovranitetit në Liban dhe forcimit të institucioneve të këtij shteti.

Që kur ka nisur lufta në Gazë në mes të Izraelit dhe Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga

Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - Hezbollahu dhe Izraeli kanë këmbyer zjarr në kufi pothuajse në baza ditore.

Tensionet u përshkallëzuan në fillim të këtij muaji, me Izraelin që kryen sulme ajrore në mbarë Libanin dhe ka nisur një operacion tokësor në jug të këtij shteti, ku ka prani të Hezbollahut.

Hezbollahu është shpallur organizatë terroriste nga



Shtetet e Bashkuara, ndërkaq Bashkimi Evropian ka futur në listën e tij të zezë krahun ushtarak, por jo dhe partinë politike të grupit. Partia e Hezbollahut ka ulëse në Parlamentin libanez.

Opozita kërkon hetime për përfshirjen e Mihalit në tregtimin e rrymës dhe ndërhyrjet në KEK

Të enjten është mbajtur seancë e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kosovës, e thirrur nga grupi parlamentar i LDK-së, i mbështetur edhe nga 43 deputetë të tjerë lidhur me situatën në Korporatën Energjetike të Kosovës. Opozita ka kërkuar hetime për përfshirjen e Dejana Mihalit në tregtimin e rrymës dhe ndërhyrjet në KEK. Edhe në këtë seancë nuk ishin të pranishëm deputetët e LV-së dhe kabineti qeveritar



menaxhimin në KEK dhe në procesin e rekrutimit, duke përfshirë punësimet e jashtëligjshme; Kuvendi obligon Bordin e KEK-it dhe institucionet përgjegjëse për menaxhimin e energjisë që ta rrisin transparencën, duke përfshirë publikimin e kontratave dhe raportimin e detajuar mbi performancën financiare dhe operacionale; Kuvendi rekomandon që Qeveria e Kosovës të marrë masa për përmirësimin e qeverisjes në KEK duke emëruar një bord të pavarur dhe profesionist me qëllim që të sigurohet funksionimi efikas dhe i përgjegjshëm i ndërhyrjes; dhe Kuvendi kërkon nga Qeveria e Kosovës dhe Bordi i KEK-it që të raportojë çdo tre muaj për situatën në KEK, përfshirë masat e marra për përmirësimin e menaxhimit të prokurimit publik, transparencën dhe procesin e punësimeve. Në mungesë të kuorumit rezoluta nuk u hodh në votim. Kryeparlamentari Glauk Konjufca ka thënë se rezoluta do të hidhet në votim kur do të ketë kuorum të mjaftueshëm. Gjatë debatit deputetët e opozitës kanë theksuar se raportet tregojnë se KEK-u ka lidhur kontrata jo të favorshme që kanë dëmtonuar stabilitetin financiar të korporatës.

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 24 TETOR - Të enjten është mbajtur seancë e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kosovës, e thirrur nga grupi parlamentar i LDK-së, i mbështetur edhe nga 43 deputetë të tjerë lidhur me situatën në Korporatën Energjetike të Kosovës. Në këtë seancë, përveç kryeparlamentarit Glauk Konjufca, nuk ishin të pranishëm deputetët e LV-së dhe kabineti qeveritar. Shefi i GP-së të LDK-së, Arben Gashi, ka deklaruar se këtë seancë e kanë thirrur me qëllim të diskutimit lidhur me skandalet dhe keqmenaxhimin në KEK. "Kjo seancë është e domosdoshme për zhvillimin e një debati të gjerë parlamentar lidhur me situatën alarmante të shkaktuar në KEK. Kjo seancë ka

për qëllim që Kuvendi të adresojë këto shqetësime dhe të diskutohen masat që duhet të ndërmerren për ta përmirësuar menaxhimin në KEK, për ta rritur transparencën dhe për t'i ndaluar ndërhyrjet e paligjshme", ka thënë Gashi.


Ai shtoi se çështjet specifike që kërkojnë të trajtohen gjatë këtij debati janë: skandalet me tenderët njëburimorë dhe mungesa e konkurrencës në prokurimin publik në KEK, shitblerja e energjisë elektrike dhe ndikimi financiar në financat e vendit, ndërhyrja e personave jashtë institucional në menaxhimin e KEK-it, dhënia e tenderëve, punësimet dhe tregtinë me energjinë, përfshirja e personit të quajtur Dejana Mihali si koordinator e LV-së dhe ndërhyrjet e paligjshme në KEK, përfshirë punësimet.

Gashi, gjithashtu, ka propozuar votimin e një rezolute që

përmban këto shtatë pika: Kuvendi i Kosovës kërkon nga organet kompetente t'i vazhdojnë hetimet e plota dhe të thelluara për skandalet e KEK-it, duke përfshirë keqmenaxhimin e tenderëve njëburimorë dhe mungesën e konkurrencës në prokurimin publik. Të gjitha shkeljet e konstatuara të ndiqen penalisht; Kuvendi i Kosovës kërkon nga Qeveria e Kosovës dhe bordi i KEK-it të raportojnë për kontratat e shitblerjes energjetike gjatë periudhës 2001-2024, duke përfshirë kushte të favorshme për palët e treta dhe ndikimin financiar në financa publike. Kuvendi obligon organet përkatëse që të rishikojnë këto

kontrata dhe të mbrojnë interesin publik dhe të eliminojnë secilën parregullsi; Kuvendi kërkon nga autoritetet kompetente ta hetojnë ndërhyrjen e personave të paaautorizuar në menaxhimin dhe vendimmarrjen e KEK-it, veçanërisht në lidhje me dhënien e tenderëve, tregtinë e energjisë dhe punësimin. Të merren masa konkrete për t'i ndaluar ndërhyrjet e paligjshme për të siguruar një menaxhim transparent dhe të pavarur në KEK; Kuvendi kërkon hetim të plotë për rolin e personit të quajtur Dejana Mihali dhe çdo personi tjetër që ka ushtuar ndikim të jashtëligjshëm në

Osmani dhe Kurti së bashku në ecjen tradicionale në kuadër të Muajit Ndërkombëtar të Luftës Kundër Kancerit të Gjirit



PRISHTINË, 24 TETOR - Presidentja Vjosa Osmani, kryeministri Albin Kurti dhe ministrat e deputetë morën pjesë në manifestimin tradicional informativ kulturor me moton "Zbulimi i hershëm - mbijetesë", që u mbajt në sheshin "Ibrahim Rugova", në përkujdesjen e presidentes së vendit, Vjosa Osmani, së bashku me Qendrën Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit "Jeta/Vita". Pas fjalimit të presidentes së vendit, Vjosa Osmani dhe drejtoreshës së Qendrës Kosovare

për Luftimin e Kancerit të Gjirit "Jeta/Vita", Nafije Latifi, kryeministri Kurti dhe të pranishmit, morën pjesë në ecjen tradicionale që filloi nga sheshi "Ibrahim Rugova" deri te sheshi "Zahir Pajaziti" në Prishtinë. Ky manifestim, që po mbahet për të dhjetën herë më radhë, ka për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit rreth kësaj sëmundjeje, por edhe për ta shprehur mbështetjen ndaj kujtdo që përballet me kancerin. Kanceri i gjirit është i shërueshëm atëherë kur zbulohet herët. Për

dallim nga viti 2022, në vitet 2023 dhe 2024 mbi 52 % e rasteve që janë diagnostikuar janë raste në fazën e parë dhe të dytë. Pra, kjo nënkupton që janë zbuluar më herët, dhe suksesi në trajtim është shumë më i lartë. Nga kanceri i gjirit preken edhe burrat, edhe pse më rrallë: 0.5-1 % të rasteve të kancerit të gjirit ndodhin te burrat, ndërsa 1 në 8 gra diagnostikohen me kancer të gjirit. Nga ky vit, mamografia bëhet falas në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Shprehet gatishmëria e bashkëpunimit në mes të qeverisë, institucioneve të sigurisë dhe KFOR-it

PRISHTINË, 24 TETOR - Kryeministri Albin Kurti ka pritur të enjten në takim komandantin e ri të KFOR-it, gjeneralmajor Enrico Barduani. Ai i uroi mirëseardhje në Kosovë dhe suksese në detyrën e re, Barduanit, teksa shprehu gatishmërinë dhe vullnetin për

bashkëpunim të afërt ndërmjet qeverisë, institucioneve të sigurisë dhe KFOR-it. Biseduan rreth rëndësisë së komunikimit të rregullt dhe bashkëpunimit të shërbimit të sigurisë dhe paqes në vend, dhe bashkëpunimit dhe aktiviteteve të përbashkëta të KFOR-it dhe institucioneve të



sigurisë së Kosovës. Kryeministri falënderoi KFOR-in për rolin dhe kontributin e vazhdueshëm në Kosovë. Gjeneralmajori Enrico Barduani është oficeri i 14-t italian që merr komandën dhe do të jetë komandanti i 29 i KFOR-it. Ai mori komandën më 11 tetor të këtij viti.



INTERVISTË ME ZOGE SHALËN, ANËTARE E GRUPIT TË TË RINJVE TË PEJËS TË PAJTIMIT TË GJAQEVE NË KOSOVË 1990-1991 (2)

Çdo falje gjaku çonte drejt pajtimit dhe bashkimit të popullit tonë

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 24 TETOR -

“Epoka e re”: A keni përjetuar ndonjë rast të rëndë, kur keni pasur mendimin se po kërkonit tepër nga familja e dëmtuar ngaqë dorasi, mbase edhe familja e tij, s’e meriton faljen e gjakut, plagës apo ngatërresës?

Zogë Shala-Malaj: Kam përjetuar, si jo. Çdo rast ka qenë i rëndë, se vetë fjala “vrasje” është e rëndë. Pra, ka pasur raste kur e kam pyetur veten: “Pse erdha në këtë familje dhe ia hapa plagën e madhe që kishte?” Por, qëndrimi i matur dhe i arsyeshëm i atyre familjeve ndaj neve, na linte pa fjalë! Na jepej kurajë dhe vullnet për punën e mëtutjeshme. Sado e dhimbshme të ishte ngatërresa,

plaga apo gjaku, e falnin dhe e shtrinin dorën e pajtimit për Kosovën.

“Epoka e re”: Çfarë ju ka motivuar veçanërisht që të angazhoheni për t’u arritur falja dhe pajtimi?

Zogë Shala-Malaj: Çdo gjak, çdo plagë, çdo ngatërresë që falej çonte te bashkimi i dy familjeve të hasmuara. Kjo për ne shihej si një hap më afër synimit final: unifikimit dhe përgatitjes së popullit tonë për luftën e domosdoshme çlirimtare të Kosovës, që do të na sillte triumfin dhe lirinë.

“Epoka e re”: Keni qenë studente apo nxënëse gjatë periudhës së Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve 1990-1991 në Kosovë?

Zogë Shala-Malaj: Studente në

shkencat matematikore.

“Epoka e re”: Si ka shkuar puna me ligjëratat apo dhe provimet?

Zogë Shala-Malaj: Unë i kam ndërprerë studimet gjatë gjithë periudhës njëvjeçare (1990-1991) të Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve në Kosovë, sepse gjatë gjithë ditëve të javës kemi qenë të angazhuar në aksion.

“Epoka e re”: Nëse ju ka ndodhur gjatë pajtimit të gjaqeve të flini, shkaku i rrethanave të ndryshme, jashtë familjes, a e keni pasur mirëkuptimin e saj apo kjo gjë ka paraqitur problem për ju?

Zogë Shala-Malaj: Gjatë gjithë kohës së pajtimit të gjaqeve në shtëpi kam shkuar njëherë në tri javë ose në muaj një natë, sa me u çmall me familje, se dihet që

në atë kohë veç sa kishim dalë nga burgu, kështu që kam pasur mirëkuptimin e familjes, por edhe të shoqërisë. Kanë qenë ditë të vështira, por edhe njëherë e them se bashkëveprimtarët na kanë ofruar shtëpitë e tyre si të ishim në familjet tona. Lirisht mund të them se familjet si të Adem Grabovcit, Ibrahim Dreshajt, Lulëzim Etemajt, Adem Krasniqit të Komunës së Rahovecit, Adnan Abdullahut në Tetovë, Ejup Bajramit në Korroticë dhe Gani Elshanit në Krojkovë të Drenasit dhe shumë familje të tjera, të cilat që pas faljes së gjakut na ofruan dhe na e hapën derën e shtëpisë e na dhanë edhe për të ngrënë, na kanë llogaritur dhe trajtuar si të ishim bijat e tyre. Mirënjohjen time të përhershme për çdonjerën prej tyre!

Momente të shkëlqimit kulminant të zemërbardhësisë sonë shqiptare

“Epoka e re”: Edhe një herë: Cili është paragjykimi më ekstrem që e keni ndeshur gjatë pajtimit të gjaqeve?

Zogë Shala-Malaj: Jodomosdoshmërisht me dëshirë, do ta tregoj një rast të ndodhur në fshatin Zatriq të komunës së Rahovecit, kur i zoti i odës ka tentuar të ma ndaloi hyrjen brenda, duke insistuar të më çoi atje ku rrinin gratë. “Shko ti te gratë, se nuk është oda për gra”, më është drejtuar kur po hynim në odën e mbushur me burra.

Reagimi i bashkëveprimtarëve Lulëzim Etemaj dhe Begzad Gashi, si dhe shpjegimi i tyre këmbëngulës se kjo jo vetëm që duhet të hyjë në odë, por për

sonte edhe e ka fjalën kryesore dhe se do ta ulim në ballë të oxhakut, ka bërë që të më jepej leja për të hyrë edhe unë.

Për befasinë e këndshme të të gjithëve, edhe të disa burrave të fshatit që kishin ardhur në odë, i zoti i odës, pasi që flasin disa nga bashkëveprimtarët e mi, duke ndrojtur që do të më ketë ngelur hatri, më drejtohet me keqardhje dhe përplot njerëzi: "Ti që erdhe dhe hyre në odën time, pse s'e fole ende as edhe një fjalë të vetme?"

Pasi e falënderova për mikpritjen dhe fjalën e dhënë, i bëra dhe unë një shpjegim mbi rëndësinë së zhdukjes së gjakmarrjes, duke i kërkuar t'ia falë gjakun rinisë së Kosovës, të ardhmes së saj më të mirë. Plaku, ngrehet në këmbë dhe më thotë: "Unë gjakun do ta fal ty, Kosovës, popullit të Kosovës. Të qoftë fal gjaku!". "Bija ime, dëgjo çka po të them: Sa herë që ti do të vish në komunën tonë, dyert e shtëpisë sime i ke të hapura. Do të jesh si bijat e mia, sepse këtij konaku prej sot iu shtua edhe një bijë", janë këto fjalët, të pikura nga zemra, me të cilat ky zemërbardhë, së bashku me gjakun e falur, më përcolli mua dhe shokët përtej dyerve të oborrit.

Konsideroj që jam shumë më fat dhe ndihem e privilegjuar që kam pasur rastin të përjetoj momente të tilla të shkëlqimit kulminant të zemërbardhësisë sonë shqiptare!

UÇK-së forcën vendimtare ia dha Lëvizja për Pajtimin e Gjaqeve

"Epoka e re": Cili është, sipas jush, sukcesi kryesor i Lëvizjes së Pajtimin të Gjaqeve?

Zogë Shala-Malaj: Në fillim të aksionit për pajtimin e gjaqeve nuk kemi menduar që do të ketë aq shumë gjaqe, plagë apo ngatërresa. Por, gjatë ditëve në vazhdim morëm informata të reja dhe kështu u rritë numri i të identifikuarve që kishin për të

falë ndonjë gjak, plagë apo dhe ngatërresë. Ishim të vendosur që do të trokasim derë me derë deri në pajtimin e rastit e fundit dhe nuk do të ndalemi derisa të mos ketë familje të hasmuara. Suksemi kryesor ishte në radhë të parë pajtimi i dy familjeve, që ato të jenë të lira, të ishin të bashkuara, sepse qëllimi kryesor i këtij aksioni ishte parapërgatitja për luftën çlirimtare të Kosovës. Prandaj pajtimi i gjaqeve, plagëve dhe ngatërresave ishte një fazë paraprijëse e formimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Jorastësisht në shumë raste na janë bashkëngjitur jo vetëm edhe shumë nga ushtarët e mëpastajmë të UÇK-së, por madje edhe disa nga drejtuesit e të lartë të saj, si komandantë apo dhe drejtues politikë. Thjesht i gjithë populli ishte me ne. E vlen për ta theksuar patjetër: Fillimisht na kanë përkrahur dhe na janë bashkëngjitur, pas ftesës që u është bërë nga nismëtarët e pajtimit të gjaqeve, profesorët e Universitetit të Prishtinës, Anton Çetta dhe Zekirja Cana.

"Epoka e re": Çfarë nëse nuk do të kishte një Lëvizje të tillë në Kosovë?

Zogë Shala-Malaj: Jam e bindur se pa pajtimin e gjaqeve nuk do të kishte UÇK. Së paku edhe për shumë kohë. Lind pyetja, pse? Sipas të dhënave tona, numri i pajtimeve të arritura është 2 511. Prej tyre, 1 169 janë gjaqe të falura; 477 është numri i plagëve, ndërsa 865 janë ngatërresa. Në një gjendje të tillë hasmërie mes vete, e shoh si gjë të pamundur t'i dilnim përballë një armiku siç ishte Serbia dhe në fakt siç u dëshmuva gjatë luftës. Po të provonim një gjë të tillë, pra pa e kryer pajtimin e gjaqeve, gjenocidi i ushtruar mbi ne nga ushtria dhe policia e Serbisë, nga i cili nuk u kursyen as foshnjat në djep, do të ishte i përmasave shumë të mëdha, mbase edhe fatale për mbijetesën tonë si shqiptar në Kosovë.

T'i kthehem fillimit të përgjigjes:

UÇK i ka rrënjët shumë të hershme, duke filluar nga prijësi i Lëvizjes Kombëtare Çlirimtare në Kosovë, Adem Demaçi, pastaj Metush Krasniqi, Fazli Greçevci, Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka e Bardhosh Gërvalla, Mehmetriza Murtezani-Gega, Rexhep Mala e Nuhi Berisha, Afrim Zhitia e Fahri Fazliu, Bajram Bahtiri, Ali Ajeti, Çeta e Llapit, heronj të tjerë të shumtë si dhe përpjekjet e të gjithë të burgosurve politikë, por asaj forcën më të madhe, vendimtare, ia dha Lëvizja për Pajtimin e Gjaqeve në Kosovë 1990-1991. Dhe nuk është e rastësishme dhe as për t'u çuditur se ajo që nga fillimi është shoqëruar pashkëputshëm nga motoja e Adem Demaçit nga romani "Gjarpitje e gjakut": "Jo atyne që janë trima me ngrehë gishtin e kimit, por atyne që janë burra me shtri dorën e pajtimit".

Asnjë popull as shtet nuk e ka një vlerë të tillë me karakter human dhe kombëtar

"Epoka e re": Pavarësisht prej pajtimit të suksesshëm të gjaqeve në vitin 1990, gjakmarrja po vazhdon edhe pas luftës. Kuptohet, jo me atë intensitet. Cila mund të jetë tani qasja e duhur ndaj saj, si nga institucionet e shtetit ashtu edhe nga qytetarët dhe shoqëria civile?

Zogë Shala-Malaj: Për fat të keq gjakmarrja po vazhdon ende. Qytetarët e Kosovës duhet nganjëherë ta kthejnë kokën pas, ta kujtojnë historinë, të kaluarën e tyre, ta kujtojnë dhe t'i referohen aksionit të pajtimit të gjaqeve, ta kujtojnë luftën dhe sakrificat tona të shumta për liri. Të reflektojnë dhe të heqin dorë nga akti i hakmarrjes, sepse ai shkon jo vetëm në dëm të familjeve të prekura direkt, por edhe në dëm të shoqërisë sonë dhe shtetit të Kosovës. Imazhi ynë si qytetarë dhe si shoqëri që praktikon ende gjakmarrjen, të



cilin ne e përcjellim tek ambasadorët e shumtë dhe prania tjetër ndërkombe të Kosovës, është një imazh që na dëmton edhe në përpjekjet dhe synimet tona që Kosova të jetë pjesë e Bashkimit Evropian dhe institucionet e tjera euroatlantike.

Shoqëria civile, mediet, shkollat dhe organizata të ndryshme duhet të jenë më aktive nëpërmjet fushatave, emisioneve të shpeshta si dhe bisedave për pajtimin e gjaqeve, duke marrë si shembull pajtimin e vitit 1990. Asnjë popull as shtet nuk e ka një vlerë të tillë me karakter human dhe kombëtar. As edhe një popull as shtet tjetër në historinë e tij nuk e ka një aksion të tillë çfarë e kemi ne. Aksioni për Pajtimin e Gjaqeve në vitin 1990 në Kosovë është unik. Institucionet tona të shtetit duhet ta zbatojnë me rreptësi ligjin, që rastet e gjakmarrjes të mbesin të izoluara dhe të mos shërbejnë si nxitëse për të tjera. Kështu kthehet besimi i qytetarëve në to dhe nuk vazhdon marrja e drejtësisë në duar nga ana e tyre.

"Epoka e re": Na e përshkruani si ka rrjedhë prej fillimit deri në mbarim përgatitja e një rasti për faljen e gjakut, duke filluar nga ajo se si e keni marrë informacionin, kontaktet, bisedat...

Zogë Shala-Malaj: Disa raste i kemi pasur të evidentuara. Sepse secili nga ne i kemi njohur ndonjë nga familjet të cilat kanë qenë në hasmëri por, gjatë aksionit, me ndihmën e qytetarëve, kemi marrë informata shtesë dhe kemi mbajtur evidencë. Fillimisht kemi kontaktuar me familjen e

dëmtuar. Mund të them se çdo familje na ka pritur mirë. Gjatë bisedave me to iu kemi shpjeguar për aksionin, qëllimin e tij si dhe rëndësinë që ka falja e gjaqeve, shtrirja e dorës së pajtimit dhe bashkimi i popullit tonë për sfidat që na presin si popull në përpjekjen tonë për të qenë të lirë dhe të pavarur. Na ka rënë të ndeshim në raste të vrasjeve të rënda, sepse dallojnë mënyrat e vrasjes nga njëra-tjetra, por trajtimi nga ana jonë ka qenë i njëjtë. Krahas qëndrimit tonë dhe argumentimit këmbëngulës se pse duhet të ndodhte falja dhe pajtimi, për familjet ka qenë rrethanë lehtësuese fakti se gjaku, plaga apo ngatërresa i falej rinisë, i falej Kosovës dhe të ardhmes së saj më të mirë.

Ka pasur raste për të cilat jemi takuar disa herë radhazi derisa familjet vullnetarisht, në bazë të bindjes së tyre, kanë shprehur gatishmërinë për të na e falur gjakun, plagën apo ngatërresën. Më pastaj e kemi njoftuar familjen e dëmtuar dhe kemi kërkuar prej saj që ta çmojë dhe nderojë familjen që ka falur. Profesor Anton Çetta në raste të caktuara vinte edhe gjatë ditëve të javës, por edhe në fundjavë. Ai ishte krahu ynë i djathtë për përgatitjen e rasteve më të vështira dhe ishte me ne që prej ndërhyrjes së parë në Lumbardh, më 2 shkurt 1990. Për t'ia rritur madhësinë aktit të pajtimit, i kemi ftuar zakonisht në fundjavë edhe profesorët si Zekeria Cana dhe shumë profesorë dhe intelektualë të tjerë që të merrnin pjesë në ceremoninë e shtrirjes së dorës së pajtimit. (Vijon)



Shqiptarëve në jug të Serbisë nuk u njihen diplomat e Kosovës

Nevzad Lutfiu, kryetar i Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve, thotë se më shumë se 10 gjenerata të të rinjve shqiptarë nga Lugina e Preshevës përballen me problemin e diplomave

PRISHINË, 24 TETOR - Marrëveshja e re e nënshkruar në samitin e Procesit të Berlinit parashih bashkëpunim më të mirë rajonal dhe mobilitet më të madh të studentëve në Ballkanin Perëndimor, por qytetarët e nacionalitetit shqiptar në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës në Serbi, përballen me probleme të vjetra. Atyre nuk u njihen ende diplomat e marra në Kosovë pavarësisht prej marrëveshjeve të mëparshme, përfshirë një në vitin 2022, e cila ka të bëjë me njohjen reciproke të diplomave universitare.

Kjo paraqet pengesë për punësimin në Serbi, ndaj të rinjtë shpesh largohen nga ky vend. "I kam humbur të gjitha shpresat se do ta zyrtarizoj në Serbi diplomën universitare që kam marrë në Prishtinë dhe do të punësohem me të në Preshevë ose Bujanoc", thotë një 30-vjeçarë për "Radion Evropa e Lirë". "Unë kam vendosur - do të shkoj te vëllai im në Zvicër. Derisa të gjej punë, do të kujdesem për fëmijët e tij", thotë ajo, duke u shprehur e zhgënjyer me të gjithë politikanët në Serbi, Kosovë dhe Evropë, të cilët, siç thotë, "e kanë fajin" për problemin e mosnjohjes së diplomave. Ajo nuk do që të identifikohet, për të mos krijuar, siç thotë, probleme shtesë për veten dhe familjen e saj.

Kryeministrat e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor - Kosovës, Shqipërisë, Serbisë, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi dhe Bosnjë-Hercegovinës - nënshkruan Marrëveshjen për qasje në arsimin e lartë dhe pranimin në studime në Ballkanin Perëndimor në samitin e Procesit të Berlinit më 14 tetor.

Kjo është një marrëveshje e re, qëllimi i së cilës është ta rrisë lëvizshmërinë e studentëve dhe t'u japë atyre të drejtën për të studiuar në institucionet e arsimit të lartë, të akredituara në rajon.

Në komunën e Preshevës, të Bujanocit dhe të Medvegjës qytetarët e nacionalitetit shqiptar ende presin që Serbia të nisë njohjen e diplomave të marra në fakultetet në Kosovë - gjë që është dashur të zgjidhej qysh pas samitit të Berlinit në vitin 2022.

Mes të tjerash, atëkohë është nënshkruar edhe Marrëveshja për njohjen reciproke të diplomave universitare, të cilën autoritetet arsimore në Serbi nuk e zbatojnë kur bëhet fjalë për diplomat e marra në universitetet në Kosovë. Për Serbinë, i diskutueshëm është termi "Republika e Kosovës" në diploma.

Asnjë nga bashkëbiseduesit e Radios Evropa e Lirë nuk mund të japë as të dhëna të përafërta për numrin e të rinjve nga jugu i Serbisë, të cilët presin që diplomat e tyre të marra në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, të certifikohen në Serbi, por vlerësimet e tyre janë se ky problem prek deri në disa qindra njerëz.



Nga viti 2008 e deri më sot, parti dhe grupe të ndryshme politike shqiptare, organizata nga sektori joqeveritar dhe Këshilli Kombëtar i Shqiptarëve kanë ndërmarrë herë pas here iniciativa dhe aksione për anulimin e vendimit për mosnjohjen e diplomave nga Kosova, por asgjë nuk e ka ndryshuar qëndrimin e Beogradit zyrtar.

Një protestë e tillë, e organizuar nga Këshilli Kombëtar i Shqiptarëve, është mbajtur më 12 gusht të këtij viti në Bujanoc, ku problemi i diplomave të panjohura është cilësuar si një formë e diskriminimit ndaj shqiptarëve në jug të Serbisë.

Barrierat administrative

Në anketën e Qendrës për Hulumtim dhe Monitorim (CZIM) nga Presheva, të realizuar në shtator në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, në lidhje me përvojat personale të diskriminimit, të anketuarit nën moshën 30-vjeçare kanë përmendur më së shumti këtë problem - mosnjohjen e diplomave të lëshuara nga institucionet arsimore të Kosovës.

Kujtim Sadriu, drejtor i kësaj qendre, thotë për Radion Evropa e Lirë se pas dy marrëveshjeve që kanë të bëjnë me njohjen e diplomave dhe lëvizshmërinë më të madhe të studentëve, të nënshkruara në kuadër të Procesit të Berlinit, ai nuk sheh asnjë arsye që "Beogradi t'i keqtrajtojë dhe diskriminojë shtetasit e tij shqiptarë, për faktin se diplomat e tyre kanë mbishkrimin Republika e Kosovës". "Nëse autoritetet në Serbi nuk i shqetësojnë më dokumentet personale dhe automjetet me tabela të regjistrimit të Republikës së Kosovës, pse i shqetëson një diplomë nga Kosova, për të cilën

një person i zakonshëm, një qytetar i Serbisë, është përpjekur për tre, katër apo më shumë vjet? Pa diplomë të njohur, ai detyrohet të shkojë jashtë vendit me biletë njëdrejtimitë", thotë Sadriu, duke shtuar se "pa ekspertë, nuk ka përparim në shoqëri". "Këtu duhen mjekë, inxhinierë, ekonomistë, juristë... dhe shteti duhet të luftojë për secilin prej tyre, e jo, me masat e veta, t'i detyrojë të dalin jashtë vendit. Pikërisht kjo po ndodh këtu. Pa diploma nuk ka punësim dhe pa punë nuk ka kushte jetese", thotë Sadriu.

Ai i bën thirrje Agjencisë së Kualifikimeve të Ministrisë së Arsimit të Republikës së Serbisë, e cila zbaton procedurat për nostrifikimin e diplomave, që menjëherë t'i qaset certifikimit të të gjitha diplomave të marra në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë. "Ne si qytetarë të Republikës së Serbisë me kombësi shqiptare nuk kërkojmë mëshirë, por kërkojmë që autoritetet shtetërore të respektojnë Kushtetutën, ligjet dhe obligimet e pranuar ndërkombëtarisht, të cilat na garantojnë barazi në çdo kuptim të jetës", thotë Sadriu.

Diplomë për punë në Gjermani

Nevzad Lutfiu, kryetar i Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve, thotë për Radion Evropa e Lirë se më shumë se dhjetë gjenerata të të rinjve shqiptarë nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja përballen me problemin e mosnjohjes së diplomave të Kosovës dhe numri i saktë i tyre është vështirë të përcaktohet.

"Të rinjtë tanë masivisht studiojnë në Kosovë, sepse është më afër. Atje, studimet janë shumë më lirë se në

Shqipëri apo në Maqedoni të Veriut, kështu që mosnjohja e diplomave ndikon shumë keq tek ata, sepse duhet të emigrojnë. Me ato diploma, punësohen shumë lehtë në Gjermani - njërin nga vendet më të pasura - por jo në Serbi", thotë Lutfiu. Sipas tij, pa diploma të certifikuar, të rinjtë e arsimuar nuk mund të punësohen në institucionet shtetërore, në institucionet dhe ndërmarrjet publike, e madje as në sektorin publik në nivel lokal.

Ai thotë se ky është një lloj diskriminimi, të cilin komuniteti shqiptar e ka vënë në dukje prej vitesh, dhe kërkon që Beogradi ta zgjidhë këtë problem.

"Mbrojmë interesat e Serbisë"

Ministria e Arsimit e Serbisë nuk iu përgjigj pyetjeve me shkrim të Radios Evropa e Lirë, në lidhje me zgjidhjen e problemit të nostrifikimit të diplomave nga Kosova.

Drejtori i Agjencisë për Kualifikime, Çaslav Mitroviq, thotë se diplomat e Kosovës nuk mund të njihen, sepse Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës.

Por, shton se diplomat nga periudha e administratës së Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), me vulën e OKB-së, njihen si të vlefshme në Serbi. "Dokumentet e tilla trajtohen si vendore", thotë Mitroviq.

Diplomat nga Shkupi dhe Tirana nuk kontestohen Trupi Koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës thekson se mosnjohja e diplomave universitare të marra në Kosovë, nuk shënjestron në

mënyrë selektive pjesëtarët e pakicës kombëtare shqiptare në jug të Serbisë, sepse, nëse do të ishte kështu, atëherë diplomat nga institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri dhe në Maqedoni të Veriut nuk do të njiheshin.

Sipas të dhënave që ka ky trup, nga viti 2018 e deri më sot janë certifikuar rreth 200 diploma nga Universiteti i Tiranës dhe rreth 550 diploma nga fakultete në Maqedoninë e Veriut.

Nenad Mitroviq, drejtor i Trupit Koordinues, thotë se kontestohen vetëm ato diploma që mbajnë shenjat e Republikës së Kosovës. "Diplomat që nuk e kanë vulën e UNMIK-ut, janë të dyshimta dhe nuk certifikohen, sepse në të është emri i së ashtuquajturës Republikë e Kosovës. Por, në pyetje është edhe çështja e cilësisë së mësimdhënies në ato institucione të arsimit të lartë", thotë Mitroviq për Radion Evropa e Lirë.

Mitroviq shton se në vitin 2011, në Bujanoc është hapur dega e Fakultetit Ekonomik nga Subotica, për t'u mundësuar, siç thotë, studentëve të studiojnë në qytetin ku jetojnë, por, vit pas viti, numri i studentëve të regjistruar nga nacionaliteti shqiptar është duke u zvogëluar, sipas tij.

Mitroviq thotë se partitë shqiptare, herë pas here, e ngrenë këtë çështje varësisht nga nevojat politike. "Mendoj se synimi i tyre është që ta përdorin si çështje politike - gjë që sigurisht se nuk është e mirë, sepse çdo ngritje e temave të tilla për qëllime politike, mund t'i rrisë tensionet", thotë Mitroviq. Sipas tij, është e nevojshme që të punohet me këmbëngulje dhe durim, për të gjetur një mënyrë për tejkalimin e këtij problemi.

Asociacioni pritet t'i mbetet detyrë kryeministrit të ardhshëm



PRISHTINË, 24 TETOR - Analisti politik nga Prishtina, Artan Muhaxhiri, nuk e përjashton mundësinë që kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është duke i pritur qëllimisht zgjedhjet parlamentare - të planifikuara për 9 shkurt të vitit të ardhshëm - për ta dërguar draftstatutin për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese të vendit.

"Kombinimet e reja pragmatike të autoriteteve mund të ofrojnë opsione për zgjidhje të suksesshme", thotë ai për "Radion Evropa e Lirë".

Por, shton se Kurti nuk do të mund ta shmangë këtë çështje pafundësisht, nëse i fiton zgjedhjet e ardhshme, sepse trysnia e bashkësisë ndërkombëtare do të jetë më e fortë. Ai pret që në muajt e ardhshëm Kurti ta shtojë diskursin e tij kundër Asociacionit, "duke shpresuar të ketë një efekt pozitiv zgjedhor populist".

Në fillim të kësaj jave, më 21 tetor, u bë një vit prej se përfaqësuesit e Pesëshes së Madhe - Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara, Franca, Gjermania dhe Italia - u prezantuan Kosovës dhe Serbisë draft-statutin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe, i cili duhet ta zgjidhë çështjen e pozitës së komunitetit serb në Kosovë dhe t'i mbrojtë të drejtat e tyre.

Në atë kohë, BE-ja tha se është një "model modern" për mbrojtjen e komuniteteve pakicë dhe dokumenti u pranua në parim nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar

Vučić.

Por, kryeministri Kurti refuzoi ta bënte hapin e parë drejt krijimit të Asociacionit, përkatësisht ta dërgonte draft-statutin për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, edhe pse bashkësia ndërkombëtare ia kërkoi gjatë gjithë vitit.

Herën e fundit, një thirrje të tillë e bëri ndihmësi i sekretarit amerikan të Shtetit për Evropën dhe Azinë, James O'Brien, gjatë qëndrimit të tij në Prishtinë më 21 tetor.

"Radio Evropa e Lirë" pyeti Qeverinë e Kosovës nëse është duke e konsideruar dërgimin e draft-statutit në Gjykatën Kushtetuese përpara zgjedhjeve të 9 shkurtit të vitit të ardhshëm, por nuk mori përgjigje.

Duke folur për "Radion Evropa e Lirë", politologu serb, Ognjen Gogiq, thotë se nga Qeveria e Kurtit nuk mund të pritët ndonjë hap drejt krijimit të Asociacionit përpara zgjedhjeve, por as pas tyre, nëse ato i fiton partia e tij, Lëvizja Vetëvendosje.

Si argument për këtë, ai kujton se, në maj të këtij viti, Qeveria e Kurtit refuzoi ta dërgonte draft-statutin për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, edhe pse një gjë e tillë ishte kusht për pranimin e Kosovës në Këshillin e Evropës. "Kosova, me vetëdije, zgjodhi të mbetet pa u anëtarësuar në Këshillin e Evropës. Nuk është reale që ai ta dërgojë draftin për shqyrtim tani kur nuk ka asgjë para vetes", thotë Gogiq.

Franca dhe Gjermania kërkuan nga Kosova që të ndërmarrë hapa drejt formimit të Asociacionit të komunave me shumicë serbe,

menjëherë pasi Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës miratoi në prill rekomandimin që Kosova të pranojë në këtë organizatë.

Kurti, megjithatë, e refuzoi një gjë të tillë, me arsyetimin se normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë diskutohet në Bruksel, e jo në Strasburg - ku e ka selinë Këshilli i Evropës.

A mund ta bindë Perëndimi Kurtin që ta formojë Asociacionin?

Muhaxhiri, profesor në Universitetin e Prishtinës, thotë se Kurti është i vetëdijshëm se nuk do të ketë marrëdhënie të mira me ShBA-në dhe BE-në, pa e trajtuar në mënyrë konstruktive këtë temë. Sipas tij, ai nuk mund t'i humbasë pafundësisht mundësitë e rëndësishme për përparimin e Kosovës drejt integritimit evropian. "Në këtë kontekst, obligimi kryesor i kryeministrit të ardhshëm të Kosovës do të jetë që të punojë në një plan të detajuar, të bazuar në realitet, në progres të madh ndërkombëtar të Kosovës dhe në shanse më të mëdha për praninë të përgjithshme nga të gjithë aktorët. Gjithçka tjetër do të thotë vazhdim i status quo-së aktuale negative", thotë Muhaxhiri. Gogiq nga Beogradi kujton se Kurti vazhdimisht e kushtëzon formimin e Asociacionit me zbatimin e marrëveshjeve të tjera, që janë arritur në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, dhe thotë se ai do të

ndërmerre hapa konkretë vetëm nëse Serbia do ta pranonte njohjen e pavarësisë së Kosovës - de jure ose de facto. "Autoritetet në Prishtinë e refuzojnë Asociacionin si të tillë, por janë të gatshme ta konsiderojnë atë në këmbim të ndonjë lloji njohjeje nga Serbia, të cilën Serbia nuk është e gatshme ta ofrojë", thotë Gogiq.

Sa është i rëndësishëm Asociacioni për Perëndimin?

Gogiq beson se edhe pas zgjedhjeve parlamentare, Kosova do të vazhdojë t'i shmangët detyrimin për formimin e Asociacionit, sepse, siç thotë, shtetet perëndimore nuk janë të interesuara t'i vendosin Kosovës kushte më serioze për këtë çështje. Sipas tij, vendet perëndimore e mbështesin formimin e Asociacionit, por jo me çdo kusht. Megjithatë, shton se, në periudhën e fundit, ka interesim më të madh për të arritur një marrëveshje përfundimtare për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë dhe se Asociacioni është një shtyllë e pashmangshme e këtij procesi. "Është e qartë se kryeministri Kurti nuk ka ende një zgjidhje kreative për të kapërcyer hendekun e madh midis refuzimit absolut të Asociacionit - derisa ka qenë në opozitë - dhe presionit të ashpër për pranimin e tij - tani që është në pushtet", thotë Muhaxhiri. Ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Jonathan Hargreaves, tha në një intervistë për televizionin

kosovar, Klan Kosova, më 22 tetor, se dërgimi i draft-statutit të Asociacionit për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese do të mundësonte përparimin e Kosovës drejt anëtarësimit në Këshill të Evropës.

Në fillim të tetorit, ambasadori gjerman në Kosovë, Jörn Rohde, tha se Kosovës nuk i kërkohet të marrë vendim përfundimtar për formimin e Asociacionit, por se për të siguruar mbështetje për anëtarësimin në Këshill të Evropës, i mjafton ta dërgojë draft-statutin në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtim.

Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, tha se një deklaratë e tillë e bën të pakuptimtë dialogun dhe marrëveshjet e arritura në Bruksel. Zyrtarët e lartë në Serbi e përshkruajnë Asociacionin si "mekanizmin e vetëm për mbijetesën e popullit serb në Kosovë".

Kosova dhe Serbia ranë dakord për formimin e tij në vitin 2013, ndërsa më 2015 u pajtuan për parimet mbi bazën e të cilave do të duhej të themelohej.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës konstatoi po atë vit se këto parime nuk janë plotësisht në përputhje me ligjet e Kosovës, por se ato mund të harmonizohen.

Ndërkohë, vitin e kaluar, Kosova dhe Serbia e pranuan Marrëveshjen drejt normalizimit të marrëdhënieve, një nga pikat e së cilës kërkon që komunitetit serb në Kosovë t'i ofrohet një nivel i caktuar i vetëmenaxhimit, përkatësisht Asociacioni.

Lumbardhi i bashkohet LDK-së

PRISHTINË, 24 TETOR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka njoftuar të enjten për

aderimin e Lumbardhit në partinë që drejton. "Një vit më parë ia fitoi zemrën e Kosovës si fitues i Big Brother.

Tani ai po i bashkohet familjes sonë politike për të ardhmen e vendit që e do aq shumë. Mirë se erdhe në

shtëpinë e vërtetë më të madhe në Kosovë, Lumbardhi!", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook".



Murati takohet me shefin e Misionit të FMN-së për Kosovën, paraqet indikatorët ekonomikë

PRISHTINË, 24 TETOR - Gjatë qëndrimit të tij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, së bashku me guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës, Ahmet Ismaili, u takuan me shefin e Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar për Kosovën, David Amaglobeli.

Ministri Murati gjatë takimit paraqiti disa nga indikatorët

ekonomikë dhe progresin që ka arritur Kosova. Ndër të tjera, ministri Murati përmendi edhe nivelin e ulët të borxhit publik. Nga ana e tij, Amaglobeli përgëzoi Kosovën për performancën e mirë makroekonomike, që reflektohet me rritje të ekonomisë përtej parashikimeve fillestare, dhe me shkallë inflacioni të ulët, e cila në shtator shënoi 0.4%. Palët vijuan diskutimet rreth

projekteve dhe programeve aktuale, siç janë: Stand-By Arrangement (SBA) dhe Resilience and Sustainability Facility (RSF) me Fondin Monetar Ndërkombëtar si dhe përmbushjen e rekomandimeve që derivojnë nga këto programe. Palët vijuan takimin duke diskutuar për mundësitë për ta vazhduar bashkëpunimin edhe në të ardhmen.

**Më pak pensione të Trepçës në shtator 2024 se në shtator 2023**

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 24 TETOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikat e mirëqenies sociale për muajin shtator 2024. Në muajin shtator 2024, nga pensionet e Trepçës kanë përfituar 1 174 persona, ku krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, që ishin 1 482 përfitues, vërehet një rënie prej (-20,8%). Në muajin shtator 2024, krahasuar me muajin shtator 2023, kishte rënie të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet e Trepçës (-20,8 %); skema për pensionet invalidore (-18 %); skema e ndihmës sociale (-9,9 %); skema për pensionet familjare (-5 %); skema e kompensimeve për personat e verbër (-2,5 %); skema për familjet e dëshmorëve dhe

invalidët e luftës (-1 %).

Në muajin shtator 2024, krahasuar me muajin shtator 2023, kishte rritje të numrit të përfituesve nga: skema e pensioneve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (14 %); skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara (13,7 %); skema për Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike (8 %); skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 (5,9 %); skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (4,7 %); skema e pensioneve bazike të moshës (3,1 %); skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara (2 %); skema për veteranët e luftës (1,3 %); skema e pensioneve kontributpaguese të moshës (0,2 %).

**Konsumi i energjisë elektrike në gusht 2024, më i vogël sesa një vit më parë**

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 TETOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar "Statistikat e energjisë" për muajin gusht 2024 me të dhëna për prodhimin dhe konsumin e thëngjillit, prodhimin dhe konsumin e energjisë, importin dhe eksportin e energjisë, si dhe importin dhe eksportin e energjentëve të tjerë. Gjatë muajit gusht të vitit 2024, energjia elektrike bruto në dispozicion ishte 512.04 GWh, kurse konsumi i energjisë

elektrike ishte 406.66 GWh, ose (-2,28 %) më i vogël sesa me muajin e njëjtë të vitit paraprak. Pjesëmarrja e energjisë elektrike alternative në kuadër të konsumit të përgjithshëm ishte 6,63 %.

Importi i energjisë elektrike në gusht 2024 ishte 212.2 GWh, kurse eksporti i energjisë elektrike në të njëjtën periudhë ishte 164.31 GWh. (këtu është përfshirë edhe sasia e transmisionit).

Prodhimi i thëngjillit ishte rreth 609.51 mijë tonë, ose 6,17 % më pak se në muajin e njëjtë të vitit paraprak.

Zëvendësministri i Ekonomisë thotë se do t'i mbështesin përpjekjet e të rinjve në karrierën e tyre

PRISHTINË, 24 TETOR - Zëvendësministri i Ekonomisë, Getoar Mjeku, ka marrë pjesë në hapjen e edicionit të ri të Festivalit të Teknologjisë "DOKU.TECH". Festivali i Teknologjisë "DOKU.TECH" është mbështetur nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Ekonomisë.

Ekspertë të TIK-ut nga Kosova dhe bota për dy ditë flasin për ndikimin e Inteligjencës Artificiale (AI) në ekonomi dhe politikbërje. Në fjalën e tij zëvendësministri Mjeku theksoi se do të vazhdojnë t'i mbështesin këto përpjekje për t'i frymëzuar të rinjtë që ta ndjekin karrierën e tyre

dhe të kontribuojnë në zhvillimin e vendit tonë, duke synuar ta bëjnë Kosovën një vend të avancuar digjitalisht, ku njerëzit mund të gëzojnë një cilësi të lartë të jetës. Festivali "DOKU.TECH" është hapur të mërkurën dhe do të jetë i hapur për dy ditë në Tech Park Prishtina.



Izraeli, Libani dhe mirazhi i Lindjes së re të Mesme



Nga: Ghassan SALAMÉ /
The Financial Times

Gjatë historisë, liderët kanë kërkuar të riformësojnë Lindjen e Mesme. Nga lartësitë e fshatit tim në Malin Liban, mund të sodis kalimin e perandorive të njëpasnjëshme: mbetjet e bukura të një tempulli romak, një kishë bizantine ose një bunker ushtarak francez (më pak tërheqës), që janë atje për të më kujtuar tërheqjen magnetike të rajonit dhe natyrën kalimtare të pushtetit. Zona që shtrihet nga Malet Taurus deri në Shkretëtirën Arabia dhe nga Shat al-Arabi deri në Mesdhe, është strategjike, shumë simbolike, e larmishme në aspektin shoqëror dhe, për rrjedhojë, politikisht e paqëndrueshme. Vendosja e një lloj rendi mbi shtetet e saj të brishta dhe identitetet e paqarta e të paqëndrueshme, ka qenë një tundim për pushtuesit dhe për politikanët. Kiri i Persisë dhe Aleksandri i Maqedonisë u përpoqën; po ashtu, në kohët më të fundit, edhe George W. Bush. Me rënien e perandorive koloniale të shekullit XX dhe lulëzimin e epokës së pavarësisë, u krijua një hartë politike, kryesisht arbitrare, duke ndarë ndërmjet shteteve të reja (jokombëtare) male dhe fusha, pllaja dhe shkretëtira që shtrihen

përreth lumenjve Jordan, Oront dhe Eufrat. Këto krijesa moderne rezultuan të brishta, gjithnjë të kërcënuara nga përplasjet etnike dhe keqmenaxhimi politik. Ndërtimi i shtetit është një përpjekje jashtëzakonisht e vështirë në shoqëritë pluraliste, kurrë i përfunduar, gjithmonë i kthyeshem dhe shpesh i konsideruar si një mbulesë e përdorur nga një grup apo një tjetër (alavitët, tikritët, maronitët) për të imponuar vullnetin e tij. Kjo bëhet edhe më e vështirë kur hegjemonët rajonalë, që janë në ngritje, përpriqen t'i shndërrojnë këto njësi të brishta në satelitë të bindur. Kohët e fundit, Lindja e Mesme ka përjetuar shumë episode të tilla. Egjipti i Gamal Abdel Nasserit përdori një valë të zjarrtë të nacionalizmit arab në vitet 1950-'60, në tentimin për të imponuar epërsinë e tij, por ambicia e tij u frenua brutalisht nga armët superiore të Izraelit, nga makinacionet e regjimeve konservatore arabe dhe armiqësia aktive perëndimore. Irani homeinist, duke promovuar emancipimin shiit dhe islamin politik, u përfshi në një projekt të ngjashëm që nga ditët e para të revolucionit, duke çuar, ndër të tjera, në një luftë të tmerrshme tetëvjeçare me Irakun dhe sponsorizimin e grupeve të armatosura

joshtetërore si Hizbollahi në Liban, Hashd al-Shabi në Irak dhe Hamasi në Palestinë. Teherani u përpoq të organizonte këtë rrjet në një "Bosht Rezistence", i cili dukej se ishte në ngritje deri në kohët e fundit. Për të mos mbetur prapa, Turqia nën Recep Tayyip Erdoğanin ka provuar të riafirmojë ndikimin e Ankarasë përmes mjeteve më fine, por ndonjëherë edhe më të ashpra, mbi një zonë që kishte jetuar nën sundimin osman për rreth katër shekuj. I fundit që është tunduar është Benjamin Netanyahu i Izraelit. Ai flet për ambicet e tij dhe demonstroi, me fitoret e njëpasnjëshme taktike, se e ka seriozisht atë që thotë. Pas shpërthimit brutal të Hamasit më 7 tetor 2023, me vullnetin e tij ai e shndërroi Gazën në një fushë të madhe rrënojash, duke zhvendosur, bombarduar, lënë në uri dhe çnjerëzuar popullsinë e saj. Pastaj, ai u zhvendos në veri për t'i dhënë fund luftës me intensitet të ulët që Hizbollahu kishte nisur kundër Izraelit, në mbështetje të Gazës, dhe këtë e bëri në mënyrë spektakolare. Ai bombardoi portin e Hudaidës në Jemen për të ndëshkuar lëvizjen e hutëve, e cila e kishte marrë si detyrë të ndihmonte Gazën duke penguar navigacionin ndërkombëtar dhe duke lëshuar raketa drejt Izraelit.

Vazhdoi të godiste depot e armëve dhe militantët iranianë e pro-iranianë në Sirinë e copëtuar dhe të dobësuar. Në kohën e shkrimit të këtij teksti, ai po përparonte të bombardojë Iranin, si reagim ndaj sulmeve me raketa më 1 tetor, gjë që jo vetëm do të përfshijë fluturimin mbi disa vende fqinje, por gjithashtu do të tërheqë ShBA-në në ofrimin e mbështetjes. Ndërkohë, Netanyahu nuk ka lënë askënd të harrojë se qëllimi i tij kryesor mbetet aneksimi i Bregut të pushtuar Perëndimor (dhe për rrjedhojë shuarja e çdo mundësie për krijimin e një shteti palestinez), ku vrasjet e militantëve, shkatërrimi i tërësishëm i fshatrave dhe shpronësimi i tokave, nëse nuk janë dyfishuar, kanë vazhduar me intensitet. Ministri i tij i Financave, Bezalel Smotrich, është i zënë duke ndryshuar sistemin ligjor "Judea dhe Samaria", në pritje të asaj që shumë kanë frikë se do të jetë aneksimi i plotë dhe ndoshta transferimi i rreth tre milionë palestinezëve në lindje të lumit Jordan. Së fundmi, ai ka reflektuar publikisht për një shtet hebre që mund të shtrihet nga Iraku deri në Egjipt. Ushtarakisht, sjellja e Izraelit në Gazë është dukur instiktive dhe kaotike, më shumë si hakmarrje sesa si një luftë e planifikuar (Isaac Herzog, presidenti izraelit,

ka akuzuar të gjithë banorët e Rripit si bashkëpunëtorë të Hamasit dhe, për këtë arsye, si objektiva të ligjshëm). Gjatë vitit që pasoi 7 tetorin, Izraeli vazhdoi të bombardonte spitalet, shkollat, xhamitë dhe kishat, fshatrat dhe kampet, pa dekluar, ndoshta pa e ditur, se çfarë do të bëjë "ditën tjetër". Për dallim, në Liban lufta e tij ka qenë e planifikuar në mënyrë të detajuar. Përballja e fundit me Hizbollahun në vitin 2006 mbeti e papërfunduar, dhe njohësit izraelitë kanë besuar, që atëherë, se ishte e pashmangshme përballja e re me luftëtarët e Hassan Nasrallahut. Prandaj, është zbatuar një plan lufte i rafinuar deri në detajet më të vogla dhe rregullisht i përditësuar gjatë 18 viteve të fundit. Rezultati është një fushatë që kombinon inteligjencën gati në nivel fantashkence, me bombardime të pamëshirshme nga një forcë ajrore dominuese dhe dronët modernë – një fushë ku Izraeli ka epërsi të qartë, për të mos thënë mbizotërim. Deri në fund të muajit të kaluar, pas vrasjes së Nasrallahut, Netanyahu ishte në gjysmë të rrugës për të shpallur fitoren, duke vlerësuar suksesin e Izraelit në "ndryshimin për vite të tëra të ekuilibrit të fuqisë në rajon". Është i padiskutueshem rrebeshi i sukseseve taktike të Izraelit në

të dy frontet – veçanërisht pas lajmit se trupat e tij kishin vlarë në Gazë udhëheqësin e Hamasit, Yahya Sinwar. Ekspertët ushtarakë po presin me padurim inovacionet e ardhshme të Izraelit. Shumë vëzhgues pro-izraelitë janë në gjendje habie, në mos euforie, dhe kjo në mënyrë të pashmangshme ka nxitur Netanyahu të fillojë të mendojë për një Lindje të re të Mesme, të riformuar nga armët izraelite dhe që pasqyron vullnetin e hegjemonit të ri. Kartografët izraelitë kërkojnë rregullisht për të pajisur kryeministrin e tyre me harta, për të treguar nga foltoja e OKB-së një Lindje të Mesme të lulëzuar dhe të prosperuar, gati për të zëvendësuar një të errët dhe barbare.

Në fakt, nuk ka dyshim se Izraeli ka ndryshuar ekuilibrin e fuqisë, duke dëmtuar ndjeshëm Hamasin dhe Hizbollahun dhe duke e vendosur veten në një pozicion ku qeveria e tij mendon se mund të diktojë konfigurimin e ri rajonal – i ndihmuar nga ushtria e tij fitimtare, pasiviteti arab, bujaria amerikane (në armë, dollarë dhe mbështetje diplomatike), dhe një sistem i thyer ndërkombëtar. Si të mbetesh racional, e lëre më modest, nën një konstelacion të tillë yjesh?

Pyetja nuk është nëse ky ndryshim i rëndësishëm është real, por nëse është i qëndrueshëm. Çdo përpjekje e kaluar për të riformësuar Lindjen e Mesme, ka përfunduar përgjithësisht në dështim: kryeministri izraelit Menachem Begin hyri në një depresion të thellë kur analizoi rezultatet e

përpjekjes së tij në vitin 1982, dhe Bushi mund të jetë ende duke reflektuar mbi nismën e udhëhequr nga ShBA-ja, të shpallur në 2003, për të eksportuar demokracinë në të gjithë rajonin përmes ndryshimit të regjimeve.

Fillimi i riformësimit të rajonit, me inkursionin në Liban, ka qenë një mallkim për politikanët izraelitë: Begini dhe ministri i tij i Mbrojtjes, Ariel Sharon, u detyruan të jepnin dorëheqjen pas pushtimit të tyre në shkallë të gjerë në veriu fqinj në vitin 1982, që ishte justifikuar me terma shumë të ngjashëm me ato të Netanyahu sot. Shimon Peresi u mund në zgjedhjet që pasuan fushatën e tij të “zemërimit” në vitin 1996, dhe aventura e gabuar e Ehud Olmertit në vitin 2006, e kombinuar me raste korrupsioni, solli rënien e tij. Premtimi i përsëritur për një “Lindje të re të Mesme”, pas secilit prej këtyre pushtimeve, natyrisht nuk e ka parë kurrë dritën e Diellit.

A mund të veprojë më mirë kryeministri i tanishëm izraelit? Ka disa arsye të mira për skepticizëm. Së pari, ata që aspirojnë të bëhen hegjemonë, duhet të jenë të gatshëm të ridizajnojnë kufijtë dhe të promovojnë ndryshimin e regjimeve. Disa përdorime të forcës janë të domosdoshme dhe, për këtë arsye, vetëm vendet me burime të konsiderueshme ushtarake (Saddam Hussein kishte iluzionin se i zotëronte ato) përfshihen në përpjekje të tilla.

Pavarësisht se si ndiqen, këto

qëllime zakonisht kërkojnë një çmim të rëndë në jetë njerëzish dhe burime materiale. Netanyahu ka shkuar aq larg sa të parashikojë ndryshimin e regjimit në Iran, “më shpejt se sa njerëzit mendojnë”. Por, nuk është e lehtë marrja e më shumë tokave duke imponuar udhëheqës të bindur në disa vende fqinje; Izraeli vështirë se mund t’i bëjë të dyja në të njëjtën kohë, pasi çdo objektivi (dhe ndonjëherë dy) do të kundërshtohet me vendosmëri nga akterët e tjerë.

Arsyeja e dytë për skepticizëm është se pasiviteti i regjimeve arabe, gjatë vitit të kaluar, lidhet ngushtë me identitetin e objektivave kryesore të Izraelit – dy kampionët pro-iranianë të islamit politik. Duke i shkatërruar ata, Izraeli gjithashtu po godet atë që shumica e regjimeve arabe e konsiderojnë si kundërshtarin më të madh. Kur aktiviteti i Izraelit tejkalon këtë përputhje rastësore të interesave, pasiviteti arab mund të zhduket papritmas. Përpjekjet për të transferuar palestinezët në vendet fqinje, në veçanti, do të kundërshtoheshin si një burim i madh i paqëndrueshmërisë politike. Përpjekjet e Izraelit për të imponuar një formë hegjemonie politike në Levant, nuk do të ishin të pranueshme për Egjiptin apo Arabinë Saudite dhe hegjemonët e tjerë rajonalë. Arsyeja e tretë është se përdorimi i tepruar i forcës do t’i mbajë kundërshtarët e Izraelit në një gjendje të vazhdueshme zemërimi. Izraeli mund të grumbullojë fitore taktike, por nuk mund t’i shndërrojë ato në

një hegjemoni të qëndrueshme. Me çështjet themelore që mbeten të pazgjidhura, Hamasi (ose një grup pasardhës) dhe Hizbollahu mund të rishfaqen në çdo moment gjatë viteve të ardhshme, meqë poshtërimi i tyre i fundit është më shumë një nxitje sesa një pengesë (ka arsye për të besuar se, ndërsa janë bombarduar tmerrësisht, të dy grupet kanë tërhequr rekrutë të rinj).

Shtetet e brishta të rajonit, kur nuk janë bashkëpunëtore të lëvizjeve anti-izraelite, vështirë se mund të parandalojnë rishfaqjen e grupeve me rrënjë të thella kulturore dhe në një kauzë që ata e konsiderojnë legjitime. Duket e mundshme që çështja palestineze do të vazhdojë të luajë rolin e një shkurre që digjet, si në Bibël, e cila shuhet vetëm për t’u rindezur menjëherë më pas.

Së katërti, një hegjemonizëm izraelit do të ndërtohej mbi një fuqi të zhveshur dhe arrogante. Të gjithë fqinjët e Izraelit janë aktualisht në mbrojtje: Siria është në fakt e pushtuar; Iraku nuk ka rifituar unitetin e tij kombëtar që nga “çlirimi” i tij dhe nuk është i organizuar me institucione të forta dhe transparente; Jordania ka frikë nga aneksimi i Bregut Perëndimor dhe mundësia e shndërrimit të saj në një shtet alternativ palestinez (diçka që ka qenë pjesë e programit të partisë Likud të Netanyahu për dekada të tëra dhe që kohët e fundit është ngritur në rendin e ditës në Tel Aviv dhe ndoshta edhe në Mar-a-Lago).

Sa për vendin tim, Libanin, ai

është financiarisht i falimentuar, politikisht i paralizuar (pa president, me një qeveri me kompetenca të kufizuara dhe një Parlament të përgjumur) dhe i kërcënuar nga rikthimi i luftës civile. Hegjemonia e Izraelit, nëse vendoset, do të ishte një fitore e lehtë, por në një mjedis të paqëndrueshëm, të frustruar dhe të zemëruar që vështirë se do të qetësohet. Edhe sikur lufta të ndalonte sot, Libanin do t’i duhen vitet për t’u rikuperuar. Izraeli do të mund të gjente informatorë në një mjedis të tillë, por do të kërkonte dëshpërimisht aleatë dhe zëvendës.

Kjo është edhe më e vërtetë sepse lloji i hegjemonisë rajonale që Izraeli po përpiqet të ndërtojë, është krejtësisht jo-gramshiane: nuk kërkon të integrojë të mundurit, por, përkundrazi, vazhdon t’i përjashtojë ata. Mesianizmi i tij ekspansionist është i pashijshëm edhe për popullatat më paqësore të rajonit, thjesht sepse ato nuk mund të kenë asnjë hise në të. Ata e konsiderojnë veten të distancuar nga Holokausti i imponuar nga evropianët ndaj hebrenjve dhe, për këtë arsye, nuk janë të gatshëm të paguajnë, edhe një herë, për krimet e Evropës. Integrimi i të dobëtëve në domenin e të fuqishmëve, siç është analizuar nga Antonio Gramsci ose shumë më përpara tij nga i madhi Ibn Khaldūn (i cili shkroi për një proces në të cilin të dobëtët pranojnë një status më të ulët për aq kohë sa janë pjesë e rrjetit të sundimitarit, ndoshta si një parakusht për hegjemoninë e qëndrueshme), është i



Paralajmërimi i ministrit izraelit të Mbrojtjes: Pasi të sulmojmë Iranin, bota do të kuptojë fuqinë tonë

Prej disa javësh pritet të shikohet se cila do të jetë përgjigja hakmarrëse e Izraelit ndaj Iranit pas sulmit me raketa. Situata në Lindjen e Mesme është në prag të luftës rajonale dhe kjo varet edhe nga ushtarak i Izraelit ndaj

Iranit. Teksa Tel Avivi e ka siguruar SHBA-në se nuk do të godasë vendet bërthamore të Iranit, një paralajmërim vjen nga ministri izraelit i Mbrojtjes. Ministri Yoav Gallant ka thënë se sulmet ajrore që Izraeli ka planifikuar ndaj Iranit do të

bëjnë botën të kuptojë fuqinë e vërtetë të ushtrisë izraelite. “Pasi të sulmojmë në Iran, të gjithë do ta mësojnë se çfarë përgatitje kemi”, ju tha ministri Gallant pilotëve gjatë një vizite në bazën ajrore Hatzetim. “Në bisedën time me pilotët theksova se pasi të sulmojmë

Iranin, të gjithë do ta kuptojnë fuqinë tonë dhe çdo armik që do të përpiqet të dëmtojë shtetin e Izraelit do të paguajë një çmim të rëndë”, shkroi në rrjetin social X ministri i Mbrojtjes pas takimit me ekuipazhin e forcës ajrore. Presidenti amerikan Joe Biden

i ka kërkuar Izraelit që në Iran të mos godasin infrastrukturën e industrisë së naftës apo lokacionet bërthamore. Izraeli e ka siguruar Presidentin Biden se nuk do t'i godasë këto dy objektiva, megjithatë kjo mbetet për t'u parë.





pamundur në këto rrethana. Në këtë aspekt, evolucioni i brendshëm i Izraelit është një pasqyrë e qartë. Që nga fitorja e tij në luftën e vitit 1967, Izraeli ka ndryshuar ndjeshëm. Kjo mund të shihet në komunitetin druzi, tradicionalisht një burim i rëndësishëm rekrutimesh për ushtrinë izraelite, ku po rritet shqetësimi për një rishikim të Izraelit që konsolidon statusin e tyre si qytetarë të dorës së dytë. Kjo u bë e qartë gjithashtu në protestat e pranverës dhe verës së vitit 2023, kur izraelitët liberalë dolën në rrugë me qindra mijëra, duke demonstruar kundër “reformave” të qeverisë së Netanyahu për gjyqësorin, të cilat synonin kufizimin e autonomisë së tij. Me fjalë të tjera, rikonfigurimi i Izraelit si një entitet gjithnjë e më fetar (siç ilustron nga ndikimi

në rritje i kolonëve në politikë dhe rritja e madhe e militantëve fetarë në radhët e oficerëve), e bën atë edhe më ekskluzivist: hebrejtë liberalë dhe – padyshim – qytetarët arabë të shtetit nuk janë të mirëpritur. Ky transformim i politikës izraelite (jo thjesht “rreshqitje drejt së djathtës”, siç raportohet shpesh) ka ecur paralelisht me përpjekjet për hegjemoninë rajonale, një kombinim që vështirë mund të qetësojë pjesë të mëdha të popullsisë izraelite apo fqinjët në rajon. Ata që perënditë i godasin me arrogancë, shpesh çlirojnë veten nga arsyeja. Sekretari i përgjithshëm i OKB-së, António Guterres, u shpall persona non grata vetëm sepse i kujtoi Izraelit se edhe për të vlejnin ligjet ndërkombëtare humanitare. Emmanuel Macron u kërcënua

me një përgjigje të ashpër sepse sugjeroi ndalimin e dërgesave të armëve drejt Izraelit. Gjykata Ndërkombëtare Penale u demonizua kur foli për krimet e luftës që po kryeshin; ende nuk dihet nëse ajo do të lëshojë fletëarrestime për udhëheqësit izraelitë. Edhe vendet që kanë normalizuar marrëdhëniet e tyre me Izraelin, janë të dezorientuara nga përkufizimi i lëvizshëm që Izraeli i bën sigurisë së vet dhe nga përbuzja ndaj shqetësimeve të tjerëve. Ngjashëm, ideja e Izraelit si një kështjellë e qytetërimit kundër barbarisë është një pretendim që gjen jehonë në Perëndim (padyshim në Kongresin amerikan), por që mezi përshkruan qytetërimet e lashta të rajonit dhe nuk pasqyron në mënyrë adekuate sjelljen e ushtrisë izraelite në Gazë. Më

afër realitetit është përpjekja e Izraelit për të qenë një kështjellë ushtarake e avancuar për Perëndimin, dhe shumë në Perëndim janë të kënaqur me këtë rol. Por, një kështjellë e avancuar ushtarake nuk mund të jetë një hegjemon rajonal, e aq më pak një fanar qytetërimi. Në këtë rajon të torturuar, të trazuar dhe të thyer, ende ekziston një mundësi për të shmangur më të keqen. Kjo mund të arrihet duke e kthyer në qendër të vëmendjes çështjen thelbësore, atë që ka qëndruar në thelbin e konfliktit për një shekull e gjysmë: të drejtat themelore politike të palestinezëve. Aventurat rajonale të Izraelit shpesh duken si një arratisje nga ky fakt i përhershëm dhe i dhimbshëm. Përveç nëse e drejta e palestinezëve për një shtet të tyre

përkrah Izraelit njihet dhe zbatohet materialisht, ata nuk do të pushojnë së qeni një burim shqetësimi (plotësisht legjitim), duke e bërë të pamundur jetën e tyre dhe atë të fqinjëve të tyre. Hegjemonët aspirues shpesh arrijnë në përfundimin se nëse forca nuk i qetëson palestinezët dhe ata që mbështesin kauzën e tyre, zgjidhja është zbatimi më i madh i forcës. Nëse historia ka ndonjë mësim, është se përdorimi i forcës për të zgjidhur çështjet komplekse politike është gjithmonë steril dhe shpesh kundërproduktiv. Në çdo rast, rrënojat e lëna nga bombardimet e tanishme të Libanit nga Izraeli nuk kanë asnjërin nga hijeshitë që lanë romakët dhe bizantinët në fshatin tim; përkundrazi, ato janë shenja të një arrogancë të pakufizuar dhe të padurueshme. /Telegrafi/



Basketbollistja Gerta Hoti pritet nga kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi

Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, e ka pritur në takim basketbollisten e talentuar Gerta Hoti së

bashku me babanë e saj Agron Hoti. "Sot pata kënaqësinë ta takoj Gerta Hotin nga Ratkoci, përndryshe talenten e re,

kampionen e Evropës me Kosovën, në basketboll, për grupmoshat U18. Gerta tashmë është transferuar te klubi

'EBSVA' në Francë, që është kampion i Francës dhe nënkampion i Evropës. Gertës i urojmë suksese dhe

përfaqësim sa më të mirë të Kosovës në gara ndërkombëtare!", ka shkruar Latifi.

Përurohen tribunat e reja dhe zhveshtoret në stadiumin e Malishevës

MALISHEVË, 24 TETOR - Kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, dhe zëvendësministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Daulina Osmani, përurojnë të enjten tribunat dhe zhveshtoret e reja në stadiumin e qytetit "Liman Gegaj" në Malishevë. Ky projekt përfaqëson një investim të përbashkët ndërmjet MKRS-së dhe komunës së Malishevës. Në ceremoninë e përuimit ishin të pranishëm zyrtarë komunalë, përfshirë drejtorin për sport, Fitim Shala, dhe drejtorin e urbanizmit, Avdi Morina, i cili ka mbikëqyrur realizimin e projektit. Shiriti i përuimit u pre nga kryetari Kastrati, zëvendësministria Osmani dhe kapiteni i FC Malisheva, Dreni Kryeziu. Kryetari Kastrati falënderoi zëvendësministren Osmani për mbështetjen e MKRS-së, duke theksuar rëndësinë e këtij bashkëpunimi për zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës

sportive në Malishevë. Ai shprehu besimin se ky bashkëpunim do të vazhdojë, duke përfshirë edhe pjesën tjetër të tribunave dhe përmirësimin e infrastrukturës përcjellëse. "Malisheva është bërë një qendër sportive me rezultate të dukshme në futboll, atletikë, not dhe sporte të tjera. Çdo investim në sport është investim në të ardhmen e rinisë sonë të shëndetshme", ka theksuar Kastrati.

Zëvendësministria Osmani vlerësoi bashkëpunimin e mirë me komunën e Malishevës dhe përgëzoi sportistët për kushtet e reja të krijuara. Ajo premtoi se MKRS-ja do të vazhdojë të investojë në infrastrukturën sportive të Malishevës dhe jo vetëm, duke mbështetur më tej zhvillimin e sportit. Ajo, gjithashtu, përgëzoi FC "Malisheva" për sukseset e fundit dhe angazhimin e tyre të vazhdueshëm. Pas ceremonisë, Kastrati dhe Osmani inspektuan nga afër tribunat e reja



dhe të gjithë kompleksin e stadiumit, i cili shquhet për stazat e tij të atletikës, duke e bërë rëndësishme sportive në nivel kombëtar.



Kosova dhe Shqipëria ngrehen në renditjen e FIFA-s

PRISHTINË, 24 TETOR - Kombëtarja e Kosovës ka përparuar për tri pozita në renditjen më të fundit të FIFA-s për muajin tetor të publikuar të enjten. "Dardanët" tashmë rriten në pozitën e 101-të pas fitoreve ndaj Lituanisë me rezultat 2-1 dhe ndaj Qipros me rezultat 3-0. Ky sukses e ka ndihmuar ekipin tonë të bëjë një hap të rëndësishëm përpara në renditjen botërore, pasi në

muajin shtator Kosova rritet e 104-ta. Pozita 101 është renditja më e mirë që Kosova ka arritur që prej pranimit në FIFA dhe UEFA, duke e barazuar atë të nëntorit të vitit 2023. Seria pozitive prej tri fitoreve radhazi në Ligën e Kombeve reflekton përmirësimin e vazhdueshëm të Kombëtares së Kosovës, e cila vazhdon të punojë me përkushtim nën drejtimin e trajnerit Foda dhe stafit teknik.

Ndërsa kombëtarja shqiptare është ngjitur dy pozicione më lart në renditjen e FIFA-s. Nga vendi 67 tani Shqipëria renditet në vendin e 65, pas suksesit në ndeshjen e fundit në transfertë ndaj Gjeorgjisë. Shqipëria triumfoi 1-0 në "Mikheil Meskhi" dhe pikërisht kuqezinjtë kanë kaluar në renditjen e FIFA-s Gjeorgjinë, por edhe Finlandën.

KB Trepça pëson humbje nga skuadra skoceze

Trepça ka pësuar humbje nga Caledonia Gladiators 76:80 (24:26, 11:19, 23:16, 18:19), në grupet e FIBA Europe Cup. Çereku i parë ishte kryesisht i baraspeshuar me të dy skuadrat që nuk arrinin të shkëputeshin, duke përfunduar 24:19, kurse skocezët ishin më të mirë në periudhën e dytë, që e fituan 11:19, për të shkuar në pushim me dhjetë pikë epërsi

35:45. Pjesa e dytë ishte shumë më interesante. Kampionët e Kosovës u rikthyen, duke afruar shifrat në 74:75, por skocezët ishin më të vëmendshëm dhe arritën të fitojnë në 76:80. Malik Johnson kishte 16 pikë, pesë kërcime e gjashtë asistime te vendasit. Kjo ishte humbja e tretë për Trepçën, derisa fitorja e parë për skuadrën skoceze.



Gjimshiti: Mbrojtja, çelësi i rrugëtimit tonë në Ligën e Kampionëve

Në edicionin e ri të Ligës së Kampionëve, Atalanta e Berat Gjimshiti është një nga skuadrat të cilat ende nuk kanë pësuar gol. Për këtë fakt kapiteni kuqez i vlerësohet shumë pasi konsiderohet lideri i mbrojtjes. "Unë mendoj se shifra zero në kolonën e golave të pësuar nga ekipi ynë tregon shumë mbi repartin tonë dhe pikën e fortë të

Atalantës. Edhe në ndeshjen kundër Sëlltikut nuk e kishim të lehtë që ta ruanim portën të paprekur. Sëlltiku është një ekip i shpejtë, i cili pret çastin për të goditur me kundërsulm. Si kolektiv kemi bërë një punë të mirë pasi kemi mbuluar zonat boshe", ka thënë Gjimshiti pas barazimit me Celticun.

Pozita : Asistent-e Administrative 1 pozitë

Vendi punës : Istog
Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.
Koefficienti i pagës 2.2

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Kujdeset për mbajtjen në rregull, ruajtjen dhe përdorimin e vulës për protokoll të dosjeve të punëtorëve;
2. Pranon, ekspediton postën sektorëve dhe njësitë punuese, personave përgjegjës, nëpërmjet librit të ekspeditimit;
3. Mban protokollin e ndërmarrjes dhe librat e dorëzimit;
4. Klasifikon dhe rradhitë lëndët e kryera dhe i vendos në pjesën e arkivit për ruajtjen e tyre;
5. Përgjigjet thirrjeve telefonike dhe jep lidhjen në lokalet e ndërmarrjes dhe jashtë;
6. Kujdeset për përdorimin ekonomik të telefonave-faksit dhe i ndalohe repretësisht përgjimi i telefonave;
7. Njofton punëtorët dhe palët me shpallje e njoftime të ndryshme;
8. Kujdeset për rregullsinë në zyren e Kryeshefit Ekzekutiv, pret mysafirët dhe i drejton në zyret e zyrtarëve sipas nevojës;
9. Kryen punë të tjera me urdhëresë të Kryeshefit Ekzekutiv;
10. Është i/e detyruar të zbatojë disiplinën në punë, kodin e etikës, rregulloret / rregullat e caktuara nga ndërmarrja për këtë proces pune dhe në rast të shkeljes së tyre mban përgjegjësi disiplinore;
11. Për mos respektimin e pikave të lartecaktuara i përgjigjet drjtëpërdrejtë, Kryeshefit Ekzekutiv

a. Kushtet e përgjithshme :

- Një CV të detajuar
- Çertifikata që kandidati nuk është nën hetime
- Letër motivimi
- Kopja e leternjoftimit
- Çertifiata mbi gjendjen shëndetsore

b. Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)

- Diplomë universitare: fakultetit juridik, administratë publike;
- Përvoja e punës: 3 vite
- Ai/Ajo duhet të ketë përvojë të menaxhimit apo profesioneve relevante, aftësi organizative dhe analitike, dhe aftësi ndër njerëzore;
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;
- Njohuri për punë në kompjuter (MS Word, Excel etj.).

Mënyra e Aplikimit: Dokumentacioni duhet të dërgohet në e-mailit krmambientikonkurset@gmail.com
Data e për aplikim është nga 25.10.2024 deri me 11.11.2024 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet origjinale mund të kërkohen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Restaurant Iliria Grill” SH.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812044329 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Restaurant Iliria Grill” D.O.O. Djakovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812044329 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Restaurant Iliria Grill” L.L.C. with headquarters Gjakovë, has come to the decision to quit its business: 812044329 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Saranda Gjonaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 dhe diplomën e Gjimanzit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimanzit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimanzit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992





ROYAL CROWN



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

